Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0900

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) PRO MEDICAL SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të KOMUNA E PODUJEVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1, me 04/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE PRO MEDICAL SH.P.K. me nr. 2023/0900, e datës 13/11/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA E PODUJEVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjeksore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1 mbetet në fuqi.

2. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Komuna e Podujevës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 08.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1. Ndërsa me datën 27.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për Lot III, për aktivitetin e lartcekur.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 26,000.00€.

Me 31.10.2023 PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga PRO MEDICAL SH.P.K., me nr. 900/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me pajisje mjeksore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1.

Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PRO MEDICAL SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - Ankuesi pretendon se "*Objekti i ofertës dhe kontratës me Autoritetin Kontraktues nuk mund te klasifikohet si sekret afarist.OE Ankues Pro Medical ka kërkuar qasje në dokumentet tenderuese të OE te rekomanduar për Kontrate për LOT III ne lidhje me Aktivitetin e prokurimit në fjale.Në bazë të përgjigjes nga përfaqësuesi i AK, nuk është lejuar qasje ne informacionin se me çfarë pajisje ka ofertuar, dhe cili është objekt i ofertës dhe kontratës me Autoritetin Kontraktues.Ju lutem shikoni email si dështmi se AK nuk ka zbatuar Vendimin e OSHP Nr.422-23 dhe LPP Neni 10 paragrafi 5.*"

Pretendimi i dytë (II) -Ankuesi pretendon se "*Vlerësimi nuk është bere konform LPP dhe arsyetimet e cekura ne LS nuk janë konform LPP. AK nuk ka respektuar as Neni 54 te LPP*

lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe në kundërshtime me RrPP Neni 42 sepse asnjë sqarime nuk kemi pranuar nga AK dhe jemi eliminuar vetëm një Arsyetim gjeneral. Pra AK nuk e ka respektuar paragrafi 3 Neni 42 i RrPP pra nuk kemi mundur as te kontestomë Vendimin e AK sepse nuk ka thëne sqarime se cilin pozioni apo pasijet nuk kemi plotësua specifikacion teknike pra kjo na ka mohur përgatitje e një KËRKESË PËR RISHQYRTIM ne baze fakteve dhe argumente për te kundërshtuar Vendimin e AK."

Pretendimi i tretë (III) - Ankuesi pretendon se "*Arsyetimit e cekura ne LS nuk janë konform LPP pra ne kemi dorëzuar email sipas kërkesës se AK konform me email, kurse ju keni thënë mundësi OE vetëm 24 ore kohe, shiko email se dëshmi por AK duhet te ketë parasysh se Periudha e vlefshmërisë se tenderit ka qene 90 ditë, nga 18.04.2023 deri 17.07.2023 kurse nga kjo date nuk ka pasur validitet kurse AK ne kundërshtim me LPP keni kërkuar veprime nga OE."*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, PRO MEDICAL SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 10, 11, 54 dhe 59 të LPP duke kërkuar që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet vendimi i AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe të lejohet qasja në dokumentet e Grupi OE të rekomanduar për Kontrate "NERAMED & KO MED.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 900/23, ndërsa me datë 26/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0900 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.."*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar "*Ju njoftojm se NUK PAJTOHEMI me mendimin e ekspertit për lëndën 2023/0900, sa i përket pretendimeve ankimore sikurse në vijim:· Lidhur me pjesën e pretendimit I-rë, Objekti i ofertës dhe kontratës me Autoritetin Kontraktues nuk mund te klasifikohet si sekret afarist.· Arsyeja e mos pajtimi në këtë pikë me ekspertin qëndron sepse është e drejtë e OE të vendos se cilat dokumente mund ti prezantoj e cilat te mbesin si sekret afarist, për më tepër edhe sipas e-prokurimit sistemi gjatë ngarkimit të dokumenteve e ka opsionin i cili mund të selektoni se cilat dokumente cilësohen si sekret e cilat jo.· Lidhur me pjesën e pretendimit që AK duhet te përgatisë versionin e pastruar ne raport me dokumentet qe cilësohen si informacione sekrete afariste, në të cilin mund të kenë qasje OE te tjerë. · Arsyeja e mos pajtimi në këtë pikë me ekspertin qëndron sepse AK ju ka dhënë qasje në dokumentacionin e OE të propozuar për dhënie të kontratës për më tepër juve ju kanë prezantuar i tërë dokumentacioni i OE të propozuar dhe keni pas mundësin ta shiqoni*

dokumentet e prezantuara si sekret afarist, andaj ne nuk mbajmë përgjegjësi pse nga ana juaj ne qasje kanë ardh përfaqësues i cili nuk ka informata per dokumentet e kërkuara (prezentuara). Ne si AK me rastin e pranimit të vendimit nga ana e OSHP 2023-0422, kemi vepruar konform vendimit por nuk do të thotë që rezultati final të ndryshoj sepse lënda është kthyer në piken zero dhe se OE ju ka mundësuar qasja ne dokumente dhe ju ka prezentuar i tërë dokumentacioni i OE të propozuar dhe keni pas mundësin ta shiqoni dokumentet e prezantuara si sekret afarist, andaj ne nuk mbajmë përgjegjësi pse nga ana juaj ne qasje kanë ardh përfaqësues i cili nuk ka informata për dokumentet e kërkuara (prezentuara), andaj kërkojmë nga bordi që të refuzoj ankesën e OE dhe të mbet ne fuqi vendimi i AK-së." ndërsa OE është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues duke theksuar " *ne pajtohemi me raportin e ekspertit sepse eksperti ka paraqitur gjendje faktike dhe AK nuk e ka respektuar Vendimin dhe rekomandim e OSHP me Nr.422/2."*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet PRO MEDICAL SH.P.K., *eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0900 ka vlerësuar si në vijim:*

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimit nr. 422/23 të lëshuar me datë 15.09.2023 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara. Sipas vendimit të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku ishte rekomanduar për kontratë grupi i OE Neramed & Ko-MED për lot III. Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë të njëjta me atë të paraqitura në ekspertizën me nr. 422/23 dhe në vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 422/23 të lëshuar me datë 15.09.2023. Përkundër që vendimi ka rezultuar me ri-vlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kanë qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që të evitoj shkeljet e konstatuara në raport të ekspertizës

dhe në vendim të OPSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes ri-vlerësimit. Por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin ri-vlerësimit edhe pse në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 16 Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues dhe konsideroj se çështja të trajtohet si " Res Judicata".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar lëndën/ankesën e operatorit ekonomik ankues PRO MEDICAL SH.P.K., si dhe ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të njëjta për palët në procedurë me vendimin Nr.2023/0422, andaj nuk janë trajtuar/shqyrtuar.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Por, Paneli Shqyrtues ka vendosur për të lënë në fuqi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjeksore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1. Për faktin se ankuesi në këtë rast nuk ka bërë zgjatjen e vlefshmërisë së ofertës dhe për këtë nuk ofron asnjë argument/provë, por ndërlidhet vetëm me shkeljet e AK.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast nuk është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke mos i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues nuk janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore dhe nuk janë bërë konstatime të sakta sepse jo të gjitha pretendimet janë të njëjta. Arsyet se Paneli nuk e përkrah në tërësi raportin e ekspertizës dhe nuk mund ta konsideroj si çështje e gjykuar për shkak se pas vendimit të OSHP Nr. 2023/0422, të datës 15.09.2023, AK e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në ri-vlerësim por në fazën e ri-vlerësimit OE ankues në këtë rast eleminohet edhe për një arsye shtesë, për shkak se nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës dhe konform nenit 30.6 të Regullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: "*Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre*". Kështu që, ankuesi për panelin shqyrtues është i

papërgjegjshëm për shkak se nuk është gjetur se i njëjti ka vazhduar validitetin e ofertës, sipas kërkesës së AK.

Arsyeja që kjo ankesë kualifikohet si pjesërisht e bazuar është për faktin se është i qëndrueshëm pohimi ankimor sa i përket AK se nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 30.4 të Regullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Po ashtu, paneli shqyrtues e mori për bazë edhe interpretimin nr. 7 të KRPP i cili gjendet në ueb faqen e eprokurimit, për shkak se AK kërkesën për zgjatjen e validitetit të ofertës e ka bërë shumë me vonesë dhe ofertat për një kohë të gjatë kanë qëndruar pa validitet, por për këtë nuk mund të penalizohen OE pjesëmarrës të cilët e kanë vazhduar validitetin e ofertës konform kërkesës së AK.

Andaj, OSHP nëse vëren se AK do të bëjë shkelje të tilla të ngjajshme, do ti drejtohet KRPP me kërkesë për inicimin e revokimit të çertifikatës ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit konform nenit 25, paragrafit 8 dhe 9 të LPP. Kjo edhe për faktin se AK Komuna e Podujevës, nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna me vendimin paraprak të OSHP Nr.2023/0422 duke mos e specifikuar qartë arsyet se cilat specifika nuk ka përputhje katalogu i ofruar, por për panelin shqyrtues tani në këtë fazë për shkak të mos vazhdimit të validitetit të ofertës nga ana e ankuesit është irelevante që aktiviteti i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim dhe AK ta sqaroj këtë pjesë.

Rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.
Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.
Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PODUJEVËS**
- OE - **PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: